

Nr. Prot. 6636/ Datë 11.12 2014

Nr. Prot. 9095/ Datë 11.12 2014

URDHËR I PËRBASHKËT

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN E STUDIMEVE TË SPECIALIZIMEVE AFATGJATA, TË CIKLIT TË I TRETË, NË FUSHËN E MJEKËSISË, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, MIRATUAR ME NUMËR PROTOKOLLI 6636/1, DATË 04.12.2014 DHE ME NUMËR PROTOKOLLI 9095/1, DATË 04.12.2014

Bazuar në nenet 26, 27 dhe 34 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kodi i Proçedurave Administrative; Ligjin Nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë; nenet 27 dhe 49 të Statutit të Universitetit Mjekësor, Tiranë, Urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 75, datë 19.02.2013 “Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në institucionet e arsimit të lartë”.

URDHËROJMË:

Në rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të i tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, miratuar me numër protokolli 6636/1, datë 04.12.2014 dhe me numër protokolli 9095/1, datë 04.12.2014,

1) Pika 2 e nenit 20 të ndryshojë si më poshtë:

“2. Të zotërojnë të paktën një nga gjuhët e huaja: Anglisht, Italisht, Frëngjisht, Gjermanisht, Spanjisht, në nivel të paktën B2 në anglisht, ose ekuivalentin përkatës, për gjuhët e tjera, për të cilat kanë dëshmitë përkatëse nga institucione të njohura në Republikën e Shqipërisë nga vendet përkatëse për testimin e këtyre gjuhëve ose nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës. Përfshihen nga detyrimi i parashikuar në këtë pikë, kandidatët që kanë përfunduar studimet “Master i Shencave”, në një vend perëndimor, në një nga gjuhët e mësipërme dhe kanë kryer atje të paktën 3 vite studimi në gjuhë përkatëse.”

2) Neni 61 të ndryshojë si më poshtë:

“Studentët e programeve specializuese afatgjatë duhet të japin para përfundimit të ciklit të plotë të studimeve provimin e gjuhës së huaj, në përputhje me Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në fuqi.”

Ministri i Shëndetësisë

Ilir BEQAJ



Ministri i Arsimit dhe Sportit

Lindita NIKOLLA

